



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

V E N D I M

Nr. 93, Datë 11/07/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 76, datë 01.07.2019, e Z. I.B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*”, nga ana e Këshillit të Ministrave dhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës rezulton se familja e Z. I.B. përbëhet nga dy bashkëshortët I.B., të cilët janë të papunë dhe në gjendje të vështirë ekonomike. Kjo familje është përfituese e ndihmës ekonomike dhe prej shumë vitesh e ka patur të pamundur pagesën e faturave të energjisë elektrike të OSHEE sh.a. Ankuesi shprehet se aktualisht ndiqet penalisht për lidhje të energjisë elektrike në mënyrë të paligjshme, pasi në fushatën e ndërmarrë nga qeveria shqiptare për detyrimin e debitorëve për shlyerjen e pagesave të prapambetura të energjisë, edhe pse kishte vullnetin e mirë, ai ishte i pamundur ekonomikisht të shlyente debinë në mënyrë të menjëherëshme, apo të lidhte marrëveshje me OSHEE sh.a., për shlyerjen e debisë në bazë të kriteve lehtësuese apo pagesës me këste. Z. I.B. thekson faktin se aktualisht marrëveshja e tij është rishikuar dhe në bazë të Vendimit nr. 767/6, datë 24.12.2015, të Këshillit

Mbikqyrës së OSHEE sh.a., ai po e shlyen debinë e tij me këste prej 1200 lekë/muaj, por vë në dukje faktin se edhe këtë tarifë nuk e përballon dot për të shlyer debinë.

Për sa më sipër, ankuesi shprehet se neni 95, i ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” përcakton një status të veçantë për familjet në nevojë duke i emërtuar “klientë në nevojë”. Sipas këtij neni, familjet që do të përfitonin statusin e klientit në nevojë do të përfitonin ndihmë financiare nga buxheti i shtetit për t’i furnizuar me energji elektrike për konsum jetik. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e këtij statusi për klientët në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, duhet të ishin miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit.

Edhe pse kanë kaluar më shumë se 1 vit, VKM në fjalë nuk është miratuar ende, fakt që e vendos familjen I.B. në një situatë diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin paraprak të ankesës nga Komisioneri.

A. Konstatimet e Komisionerit pas analizimit paraprak të ankesës nr. 76, datë 01.07.2019, së Z. I.B..

Pas kryerjes së analizimit paraprak të ankesës nr. 76, datë 01.07.2019, së Z. I.B., Komisioneri konstatoi, si vijon:

Pretendimi Z. I.B. konsiston në diskriminim, për shkak të gjendjes ekonomike, nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shkak të mos miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin e statusit për klientët në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, në zbatim të nenit 95 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për sa më sipër, Komisioneri ka shqyrtuar dy ankesa me të njëjtin objekt, sikurse ankesa e Z. I.B.. Këto ankesa janë përkatësisht:

- I.** Ankesa nr. 15, datë 22.01.2018, të subjektit ankues Rr. Rr, të mbështetur nga organizata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Elbasan, me pretendimin për diskriminim për shkak të “etnisë” dhe “të gjendjes ekonomike”, kundër Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Entit Rregullator të Energjisë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. Nëpërmjet Vendimit nr. 97, 05.04.2018, Komisioneri ka vendosur konstatimin e diskriminimit të Rr.Rr, nga ana e Ministrisë së

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shkak të gjendjes sociale dhe gjendjes ekonomike, përmes mos nxjerrjes së aktit nënligjor, në të cilin parashikohen kriteret dhe procedurat e përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyra e trajtimit të tyre, si dhe ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë aktin nënligjor përkatës për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyrës së trajtimit të tyre, sipas përcaktimeve të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

1. Ankesa nr.14 Regj, datë 22.01.2018, të znj.D. D, përfaqësuar nga organizata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Elbasan”, me pretendimin për diskriminim për shkak të “etnisë” dhe “të gjendjes ekonomike”, kundër: Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Entit Rregullator të Energjisë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. Nëpërmjet vendimit nr. 92, datë 05.04.2018, KMD ka vendosur konstatimin e diskriminimit të Znj. D. D nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shkak të gjendjes sociale dhe gjendjes ekonomike, përmes mos nxjerrjes së aktit nënligjor, në të cilin parashikohen kriteret dhe procedurat e përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyra e trajtimit të tyre, si dhe ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë aktin nënligjor përkatës për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyrës së trajtimit të tyre, sipas përcaktimeve të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Aktualisht, subjektet kundër së cilave drejtoheshin ankesat e mësipërme, i kanë kundërshtuar gjyqësisht të dy vendimet e Komisionerit, çështje, të cilat ndodhen ende në shqyrtim gjyqësor pranë gjykatës kompetente.

Në nenin 33, pika 4, gërma c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet: “Ankesa nuk pranohet nëse:c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”.

Mbështetur në parashikimin e dispozitës së sipërpërmendur, si dhe të fakteve të sipërcituara mbi dy ankesat e shqyrtuara pranë KMD-së, si dhe lidhur me faktin që objekti i ankesave është i njëjtë dhe lidhet me të njëjtën problematikë, të mos nxjerrjes së një akti normativ nënligjor nga ana e Këshillit të Ministrave, Komisioneri gjykon që ankesa nr. 76, datë 01.07.2019, e Z. I.B., nuk mund të pranohet për shqyrtim pranë këtij institucioni.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 7, 20, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma c) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 76, datë 01.07.2019, e Z. I.B., pasi e njëjta çështje është shqyrtuar në kuadër të dy ankesave të tjera, për të cilat Komisioneri është shprehur me vendim.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – te mira e sherbime
Shkak – gjendja ekonomike